



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KRYETARI I KOMUNËS**

Në bazë të nenit 58 shkronjat b) dhe g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, dhe nenit 61 paragrafët 1.2 dhe 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr. 01-020/01-0050862/18, jep këtë:

### **A U T O R I Z I M**

#### **I.**

Autorizohet z. Vigan Salihu, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik të ushtrorë funksionin nga kompetenca dhe përgjegjësitë e Drejtorit të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit.

#### **II.**

Autorizimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe i njëjti vlen deri në emërimin e drejtorit të Drejtorisë së cekur, përveç nëse me ndonjë akt tjetër vendoset ndryshe.

Nr.prot. 02-016/01-0021206/24  
Podujevë, datë: 02.04.2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 58 të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, dhe neneve 16 dhe 61 të Statutit të Komunës së Podujevës me nr.prot.01-020/01-0050862/18, nxjerr këtë;

### V E N D I M

#### Neni 1

Themelohet Komisioni ad-hoc për vlerësimin e gjendjes dhe konstatimin e shkallës së rrezikshmërisë së objektit të ndërtuar në periudhën rreth viteve 1982-1985 me destinim për “shtëpi e kulturës”, i cili gjendet në udhëkryqin që lidhë rrugët “19 qershori” dhe “Zahir Pajaziti”, në këtë përbërje:

**Ismet Kadriu**, zyrtar në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit,  
**Veton Aliu**, zyrtar në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit,  
**Kujtim Zhitia**, zyrtar në Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit,  
**Isak Uka**, zyrtar në Drejtorinë e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë,  
**Afrim Mulliqi**, zyrtar Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit,

kryesues  
anëtar  
anëtar  
anëtar  
anëtar

#### Neni 2

Komisioni sipas nenit 1 të këtij Vendimi, bën vlerësimin e gjendjes teknike dhe faktike të objektit në fjalë si dhe konstatimin e shkallës së rrezikshmërisë eventuale të objektit i cili është ndërtuar me destinim për “Shtëpi të kulturës” rreth viteve 1982-1985.

#### Neni 3

Komisioni për punën e kryer, në një afat sa më shkurtër të mundshëm, përgatitë raport të detajuar lidhur me vlerësimin e objektit të cekur si dhe rekomandon për veprimet e mëtuajtshme që duhet të ndërmerren nga ana e Komunës.

Raporti së bashku me rekomandim i dorëzohet Kryetarit të Komunës.

#### Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

- Anëtarëve të Komisionit, përmes Kryesuesit
- Drejtorëve të Drejtorive përkatëse
- QSHQ / akritiv

Nr.prot. 02-020/04-0021249/24  
Podujevë, datë: 02-04-2024



Kryetari i Komunës  
Shënjtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 58 shkronjat b) dhe g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040 dhe nenin 61 paragrafët 1.2 dhe 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr. 01-020/01-0050862/18, jep këtë :

### AUTORIZIM

Autorizohet z.Bahri Selimi, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit në Komunën e Podujevës, të veprojë dhe të nënshkruaj dokumentacionin nga kompetenca dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Administratës, derisa znj.Xhevdie Beqiri, ushtruese e detyrës së Drejtoreshës të Drejtorisë së cekur të kthehet nga pushimi, apo eventualisht deri në nxjerrjen e një akti tjetër.

Ky Autorizim vlen nga data 02.04.2024 deri më 12.04.2024.

Nr.prot. 02-016/01-0021177/24  
Podujevë, datë: 02.04.2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 16 dhe 61 parag. 1.7 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-50862/18 dhe nenit 7 paragrafët 1 dhe 2 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, në kërkesë të Drejtoreshës së Drejtorisë së Bujqësisë Pylttarisë dhe Zhvillimit Rural –DBPZHR të datës 02.04.2024, merr:

### V E N D I M

#### PËR NGRITJEN E KOMISIONIT AD-HOC PËR SHQYRTIMIN DHE VLERËSIMIN E KËRKESAVE PËR NDARJE TË SUBVENCIONEVE

##### Neni 1

Për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve sipas ftesës publike nr.12-320/01-0017267/24 të datës 11.03.2024, për përkrahje në projektin me fidane të mjedrave, ngritet Komisioni në këtë përbërje:

- |                                                                      |          |
|----------------------------------------------------------------------|----------|
| - Behë Govori, zyrtar për blektori, bletari dhe veterinari - DBPZHR, | kryesues |
| - Vahide Veseli, zyrtare për zhvillim - DBPZHR,                      | anëtare  |
| -Alban Shabani, zyrtar për evidentimin e pronës se paluajtshme-DBF   | anëtar   |

##### Neni 2

Komisioni punët, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në pajtim me Rregulloren nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022 për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve.

##### Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet:*

*Anëtarëve të komisionit*

*Drejtorisë së Bujqësisë Pylttarisë dhe Zhvillimit Rural.*

*QSHQ/Arkivit*

Nr. Prot. 02-020/04-0021330/24  
Podujevë, datë, 03.04.2024





## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13, 17 shkronja h) dhe 58 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 35.5 të Ligjit nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikës e Kosovës, nenin 12 paragrafët 1,2 dhe 3 të Udhëzimit Administrativ të (MASH) nr.151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, si dhe nenet 16, 19 parag. 1.8 dhe 61 parag.1.3 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, në propozim të Drejtorit të Drejtorisë së Arsimit, nr. prot. 02-111/01-0021213/24, datë 02.04.2024, nxjerrë këtë;

### V E N D I M PËR EMËRIMIN E PËRKOHSHËM NË POZITËN E DREJTORIT / ESHËS NË INSTITUCIONIN PARASHKOLLOR- IP "ARMELA" NË PODUJEVË

#### Neni 1

znj. Afërditë Salihu, me vendbanim në Podujevë, me nr. personal të letërnjoftimit [redacted], e kualifikuar Bachelor (BA) në Përkujdesje dhe Mirëqenie të Fëmijëve,

**Emërohet përkohësisht në pozitën e Drejtoreshës së IP "Armela" në Podujevë.**

#### Neni 2

E përmendura sipas nenit 1 të këtij vendimi emërohet përkohësisht deri në zgjedhjen/emërimin e Drejtorit sipas procedurës së rregullt të konkursit apo deri në një akt tjetër administrativ.

#### Neni 3

Kushtet e punës, të drejtat, përgjegjësitë dhe paga mujore caktohen me kontratën e punës.

#### Neni 4

Zbatimin e vendimit dhe çështjeve tjera që ndërlidhen me këtë vendim e bën Drejtoria e Arsimit.

#### Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*I dërgohet:  
Drejtorisë së Arsimit  
Të emëruarit  
QSHQ/Arkivit*

Nr. prot. 02-016/01-0021325/24  
Podujevë, datë: 03.04.2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3, nenin 26 paragrafi 1, paragrafi 3.1 dhe 3.2, të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0017955/24 të datës 14.03.2024, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencione, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot 06-400/04-0021241/24, të datës 02.04.2024, merr:

### V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

#### Neni 1

**znj.Makfire Mulolli** nga fshati Shajkoc, Komuna e Podujevës, për trajtimin mjekësor të birit të saj Valon Mulolli, për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore dhe në pamundësi të mbulimit të shpenzimeve dhe trajtimit të mëtutjeshëm mjekësor i jepet ndihmë financiare në shumë 500.00€.

#### Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë bankare të së përmendurës.

#### Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

#### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet:*

*Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS.*


*Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF*

*QSHQ/Arkivit.*

*znj.Makfire Mulolli (njoftohet përmes DSHMS-së)*

Nr.prot 02-016/01-0022026/24  
Podujevë, datë, 04.04.2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-02/01-0050862/18, nenit 11 paragrafi 1 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot. 01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, Vendimin për miratimin e Projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2024 dhe parashikimet buxhetore 2025-2026 nr.prot.01-413/01-0071612/23, dt.27.09.2023, në rekomandim të Komisionit Ad-Hoc të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0009833/24 të datës 08.02.2024, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve, sipas Ftesës Publike nr.prot. 15-300/01-003013/24 të datës 10.01.2024, Kryetari i Komunës, merr:

### V E N D I M

#### Neni 1

1. Lejohen mjete financiare për subvencionimin e tetëdhjetë (80) përfituesve me pajisje pune në Komunën e Podujevës.

2. Mbështetja financiare bëhet sipas kushteve dhe kriterëve sipas Ftesës publike për aplikim në projektin “Ngritja dhe zhvillimi i bizneseve”, përkatësisht subvencionimi në vlerë totale 111,500 €, nga e cila 70% apo 78,050 € financim nga Komuna, ndërsa participimi i përfituesve bëhet në vlerë 30% për një përfitues apo 33,450 € të shumës së investimit të përcaktuar nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik.

#### Neni 2

Qëllim i realizimit të këtij projekti është promovimi dhe zhvillimi i bizneseve ekzistuese dhe bizneset Start Up në territorin e Komunës së Podujevës.

#### Neni 3

Lista e aplikuesëve të përzgjedhur për implementimin e projektit: *Ngritja dhe zhvillimi i bizneseve*, sipas nenit 1 është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

#### Neni 4

Subvencionimit përkatësisht mbështetja financiare do të bëhet me akt të veçantë për secilin përfitues veç e veç pas verifikimit, konstatimit dhe vlerësimit të përmbushjes së kushteve dhe kriterëve nga ana e përfituesit/es si dhe çështjeve tjera të parapara sipas ftesës publike përkatëse.

#### Neni 5

Për zbatimin e Vendimit kujdeset Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik në bashkëpunim me Komisionin përkatës.


#### Neni 6

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. prot. 02-300/01-002244/24  
Podujevë, datë: 05.06.2024

Kryetari i Komunës  
Shpejtim Bulliqi





**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KRYETARI I KOMUNËS**

Në bazë të neneve 13, 17 shkronja l) dhe 58 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, nenin 5.2 (i) të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, nr.03/L-087, nenin 23 (Lista 2 nr.20) të Ligjit nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, neneve 16, 19 paragrafi 1.12 dhe 61 paragrafi 1.3, të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, dhe sipas nenit 1 paragrafi 2 të Vendimit nr.prot.01-020/04-0014612/22 për ngritjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike për Banim SH.A. Podujevë, të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Podujevës më 28 shkurt 2022, merr,

### **VENDIM PËR EMËRIMIN E ANËTARIT NË KOMISIONIN KOMUNAL TË AKSIONARËVE TË NDËRMARRJES PUBLIKE PËR BANIM SH.A. PODUJEVË**

#### **Neni 1**

Anëtar i Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike për Banim sh.a. – Podujevë, emërohet,

**Leutrim Krasniqi, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit**

#### **Neni 2**

Detyrat dhe përgjegjësit e Komisionit, përkatësisht anëtarit të emëruar, janë të përcaktuara me dispozitat e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, Ligjin nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, Ligjin nr.05/L-009 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin nr.04/L-111, dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

#### **Neni 3**


Ky Vendim është pjesë përbërëse e Vendimit të Kuvendit të Komunës, nr.prot.01-020/04-0014612/22 të datës 28 shkurt 2022,

#### **Neni 4**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, ndërsa shfuqizohet Vendimi nr.prot.02-020/02-002024/22 i datës 18 mars 2022 pasi që anëtarit i emëruar sipas këtij vendimi ka kaluar në punë dhe detyra tjera në një institucion tjetër publik.

U dërgohet;  
Të emëruarit  
Anëtarëve të Komisionit  
QSHQ / Arkivit

Nr.Prot. 02-101/03-0022486/24  
Podujevë, datë: 08.04.2024



**Kryetari i Komunës**  
**Shpejtim Bulliqi**





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3, nenin 26 paragrafi 3, nën paragrafi 4, të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0017955/24 të datës 14.03.2024, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencione, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot 02-400/04-0022189/24, të datës 05.04.2024, merr:

### V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

#### Neni 1

**znj.Diellëza Sylejmani** nga fshati Bajçinë, Komuna e Podujevës, me rastin e lindjes së katër njakëve i jepet ndihmë financiare në shumë 4000.00€.

#### Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë bankare të së përmendurës.

#### Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

#### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet:*

*Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS.*

*Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF*

*QSHQ/Arkivit.*

*znj.Diellëza Sylejmani (njoftohet përmes DSHMS-së)*

Nr.prot 02-400/03-0022484/24  
Podujevë, datë, 08.04.2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe në mbështetje të zbatimit të veprimit 3.2 të Planit të Veprimit 2022-2024 të Programit për Parandalimin dhe Zvogëlimin e Barrës Administrative 2022-2027, i miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, nr. 27.29 të datës, 14.09.2022, nxjerr:

### V E N D I M

#### Neni 1

Themelohet Grupi punues për mbarëvajtjen e procesit të zvogëlimit të barrës administrative në Komunën e Podujevës në këtë përbërje:

- Ejup Babatinca , koordinator
- Enis Sheholli, anëtar
- Ardonis Jusufi, anëtar
- Mirlinda Arifi, anëtare
- Faik Gashi, anëtar
- Fidan Salihu, anëtar
- Naime Ajeti, anëtare
- Shefrie Gashi, anëtare
- Pajtime Sadiku, anëtare
- Blerina Fejzullahu, anëtare
- Ardiana Dibrani anëtare

#### Neni 2

Përgjegjësitë e grupit punues, janë:


- Koordinimi i procesit në funksion të zvogëlimit të barrës administrative brenda Komunës, përkatësisht thjeshtësimin e procedurave administrative;
- Komunikimi, përfaqësimi dhe koordinimi me Zyrën për Planifikim Strategjik në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, për mbarëvajtjen e procesit të zvogëlimit të barrës administrative në kuadër të Komunës;
- Pjesëmarrja dhe kontrollimi i politikave publike të zhvilluara nga Komuna, në kontekst të procesit të zvogëlimit të barrës administrative;
- Bashkëpunimi dhe koordinimi me GIZ-in Gjerman, partner në përkrahjen e procesit të zvogëlimit dhe parandalimit të barrës administrative.

#### Neni 3

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:  
Zyrës për Planifikim Strategjik/ZKM  
QSHQ/Arkivi

Nr.prot. 02-020/04-0022493/24  
Podujevë, datë 08.09.2024



Kryetari i Komunës  
Sajmir Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3, nenin 26 paragrafët 1, 3.1 dhe 3.2, të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0017955/24 të datës 14.03.2024, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencione, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot 02-400/04-0022451/24, të datës 08.04.2024, merr:

### V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

#### Neni 1

**z.Xhevdet Mehmeti** nga fshati Godishnjak, Komuna e Podujevës, për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore dhe në pamundësi të mbulimit të shpenzimeve dhe trajtimit të mëtutjeshëm mjekësor i jepet ndihmë financiare në shumë 500.00€.

#### Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë bankare të përmendurit.

#### Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

#### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet:*


*Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS.*

*Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF*

*QSHQ/Arkivit.*

*z.Xhevdet Mehmeti (njoftohet përmes DSHMS-së)*

Nr.prot 02-400/04-0022904/24  
Podujevë, datë, 08.04.2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 8 të Rregullores MF - Nr – 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenin 16 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18, duke përfshirë dy përfaqësues të shoqërisë civile, në cilësinë e anëtarëve të këtij komisioni, të zgjedhur nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, përmes Thirrjes publike datë 27.03.2023, nxjerr:

### V E N D I M PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES PËR SHQYRTIMIN E APLIKACIONEVE PËR FINANCIM PUBLIK TË OJQ- ve NË KOMUNËN E PODUJEVËS

#### Neni 1

Për shqyrtimin e aplikacioneve për financimin publik të OJQ-ve, për organizimin e aktiviteteve në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit për projekt që kontribuojnë në zhvillimin dhe masvizimin e organizimeve kulturore, rinore dhe sportive, promovimin përmes pasurimit, diversifikimit dhe rritjes së cilësisë së jetës kulturore, rinore dhe sportive, sipas Thirrjes publike datë 19.03.2024, themelohet komisioni në përbërje:

- Arbër Sfishta, kryesues
- Blerina Fejzullahu, anëtare
- Alban Shabani, anëtar
- Behram Duriqi, anëtar – shoqëria civile
- Vjollca Breznica, anëtare – shoqëria civile

Blerta Ajvazi, zyrtare në DPZHE, caktohet anëtare rezervë, e cila zëvendëson anëtarin e Komisionit në rast të paraqitjes së konfliktit të interesit gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikacioneve.

#### Neni 2

Komisioni, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në përputhje me rregullat e parapara me Rregulloren për financimin publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.

#### Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*u dërgohet:*

*Anëtarëve të Komisionit*

*Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit*

*QSHQ/Arkivit*

Nr. prot. 02-020/04-0025903/24  
Podujevë, datë: 22.04.2024



Kryetari i Komunës  
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13, 58 shkronja f) dhe 62.2 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, nr.03/L-040, nenet 16, 61 paragrafi 1.6 dhe nenin 64 paragrafi 3 të Statutit të Komunës nr.prot. 01-020/01-0050862/18, merr:

### V E N D I M PËR EMËRIMIN E USHTRUESIT TË DETYRËS SË DREJTORIT TË DREJTORISË SË ADMINISTRATËS

#### Neni 1

**z.Shuajb Blakçori**, me kualifikim bachelor fakulteti ekonomik- Banka Financa, Kontabilitet: MSC Ekonomi e Gjellbër, Zhvillim i Qëndrueshëm Ekonomik, Energji e Ripërtitshme - South East European University, nga fshati Letanc-Komuna e Podujevës, emërohet;

➤ **Ushtrues i detyrës së Drejtorit të Drejtorisë së Administratës**

#### Neni 2

I përmenduri punët dhe detyrat e punës në kuadër të Drejtorisë së Administratës do t'i ushtrojë deri në emërimin e drejtorit të Drejtorisë së cekur.

#### Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet:  
Të emëruarit  
Zyrës së personelit  
QSHQ/Arkivit*

Nr. Prot. 02-101/03-0025900/24  
Podujevë, datë: 22.04.2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 11, 13 dhe 58 shkronja f) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040 dhe nenet 14 , 16 dhe 61 paragrafi 1.6 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01 - 0050862/18, merr:

### V E N D I M PËR LIRIMIN NGA DETYRA E U.D. SË DREJTORESHËS TË DREJTORISË SË ADMINISTRATËS

#### Neni 1

**znj.Xhevrie Beqiri**, lirohet nga detyra e u.d. së Drejtoreshës të Drejtorisë së Administratës në Komunën e Podujevës.

#### Neni 2

E përmendura kthehet në punët dhe detyrat e punës sipas Aktemërimit në kuadër të administratës komunale.

#### Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*I dërgohet:  
Të përmendurës  
Zyrës së Personelit  
QSHQ/Arkivit*

Nr.prot. 02-118/02-0025841/24  
Podujevë, datë: 22.04.2024



Kryetari i Komunës  
Shqipëri Buliçi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja (b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040 dhe nenin 61 par 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, Kryetari i Komunës, jep:

### AUTORIZIM

Autorizohet z.Shuajb Blakçori, U.D, Drejtor i Drejtorisë së Administratës në Komunën e Podujevës, të deponojë nënshkrimin në Qendrën e Shërbimit për Qytetarë për vulosjen e dokumentacionit që ka të bëjë me kompetencat dhe fushë veprimtarinë e Drejtorisë së cekur.

Nënshkrimi i të autorizuarit \_\_\_\_\_

*I dërgohet:*

Të autorizuarit  
QSHQ/arkivit


Nr. prot. 02-016/01-0026837/24  
Podujevë, datë, 24.04.2024

Kryetari i Komunës  
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3, nenin 26 paragrafi 3, nën paragrafët 1, 2 dhe 6, të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0017955/24 të datës 14.03.2024, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencione, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot 02-400/04-0026717/24, të datës 24.04.2024, merr:

### V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

#### Neni 1

**znj.Halime Sejdiu** nga Podujeva, për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore dhe në pamundësi të mbulimit të shpenzimeve dhe trajtimit të mëtutjeshëm mjekësor si dhe gjendjes së rënduar të banimit dhe ekonomiko-sociale i jepet ndihmë financiare në shumë 2000.00€.

#### Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë bankare të së përmendurës.

#### Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

#### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet:*  
Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS  
Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF  
QSHQ/Arkivit  
Znj.Halime Sejdiu (njoftohet përmes DSHMS-së)

Nr.prot 02-400/04-0026923/24  
Podujevë, datë, 24.04.2024







Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-02/01-0050862/18, nenet 3 parag.3, 8 dhe 15 parag. 1.1 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, Vendimin nr.prot.01-413/01-0071612/23, datë 27.09.2023, për Miratimin e Projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2024 dhe Parashikimet Buxhetore 2025-2026, sipas Konkursit për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Podujevës për vitin akademik 2023-2024 të Drejtorisë së Arsimit n. 05/52, datë 20.02.2024, në rekomandim të Komisionit Ad-Hoc datë 24.04.2024, të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot. 02-020/04-0017117/24 datë 11.03.2024, për shqyrtimin edhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të bursave, merr:

### VENDIM PËR NDARJEN E BURSIVE PËR STUDENTË

#### Neni 1

Treqind e shtatëdhjetë e gjashtë (376) studentëve të Komunës së Podujevës, të cilët vijnë në studimet në Fakultete të Universiteteve Publike në Republikën e Kosovës, u ndahen bursë në shumë 300 € për secilin student (shuma e përgjithshme 112,800 €), për vitin akademik 2023-2024.

#### Neni 2

Shuma e mjeteve individuale nuk tejkalon shumën e mjeteve financiare sipas Rregullores për kushtet dhe kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Arsimit.

#### Neni 3

Pjesë përbërëse e Vendimit është Lista përfundimtare e përfituesve të bursave nr. 05/113, datë 24.04.2024.

#### Neni 4

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Arsimit.

Nr.Prot: 02-670/01-0027130/24  
Podujevë, datë, 25.04.2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 16 dhe 61 parag. 1.7 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-50862/18 dhe nenit 7 paragrafët 1 dhe 2 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, në kërkesë të drejtorit të Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural –DBPZHR të datës 29.04.2024, merr:

### V E N D I M PËR NGRITJEN E KOMISIONIT AD-HOC PËR SHQYRTIMIN DHE VLERËSIMIN E KËRKESAVE PËR NNDARJE TË SUBVENCIONEVE

#### Neni 1

Për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve sipas ftesës publike nr.12-320/01-0021274/24 të datës 02.04.2024, në projektin përkrahje me mëshqerra, ngritet Komisioni në këtë përbërje:

- **Shefrije Gashi**, zyrtare për prodhimtari bimore - DBPZHR
- **Ardian Emini**, zyrtar për SMIA-DKA
- **Blerina Fejzullahu**, zyrtare për rini –DKRS

kryesuese  
anëtar  
anëtare

#### Neni 2

Komisioni punët, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në pajtim me Rregulloren nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022 për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve.

#### Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet:*  
*Anëtarëve të komisionit*  
*Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.*  
*QSHQ/Arkivit*

Nr. Prot. 02-020/04-0028042/24  
Podujevë, datë, 29.04.2024

Kryetari i Komunës  
Shpejtim Balliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 58 shkronjat b) dhe g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Ligjin e Punës nr. 03/L-212 dhe nenin 61 paragrafët 1.2 dhe 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr. 01-020/01-0050862/18, jep këtë :

### AUTORIZIM

Autorizohet z.Fatlum Osmani, Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave në Komunën e Podujevës, të veprojë dhe të nënshkruaj dokumentacionin nga kompetenca dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, derisa znj.Saranda Stublla, Drejtoreshë e Drejtorisë së cekur të kthehet nga pushimi i lehonisë, apo eventualisht deri në një akt tjetër administrativ.

Nr.prot.02-016/01-0028168/24  
Podujevë, datë: 30.04.2024

